



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURËS
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. 7738 prot.

Durrës, më 27.04.2018

KONTRATË MBIKQYRJE PUNIMESH
PËR
OBJEKTIN

“Mbikqyrje punimesh per objektin: Rikualifikimi i hapësirave midis Kuartallit nga rruga “Skenderbej” deri ne rrugen “Mars 91” e hapësira deri tek rruga e Portit, si dhe sistemimi i ujrave te Bardha tek ura e Dajlanit (Faza e I)+loti II”

Lidhur ndermjet paleve

Autoritetit Kontraktor :**BASHKIA DURRES**

dhe

Mbikqyrës Punimesh: **NORD - COMAT**

KONTRATË

MBIKQYRJE PUNIMESH NDËRTIMI

“Mbikqyrje punimesh per objektin: Rikualifikimi i hapësirave midis Kuartallit nga rruga “Skenderbej” deri ne rrugen “Mars 91” e hapësira deri tek rruga e Portit, si dhe sistemimi i ujrave te Bardha tek ura e Dajlanit (Faza e I)+loti II”

Baza Ligjore:

- Kontrata mbështetet në ligjin nr 9643 datë 20.11.2006 “ Për prokurimin pubik”, Ligji nr. 139/2015 “PËR VETËQEVERISJEN VENDORE” dhe në Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë.
- Në zbatim Ligjit Nr.8402 date 10.09.1998 “Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit” në mbështetje të Udhezimit te KM Nr 3 date 15.02.2001 për “Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve te Ndertimit” i azhornuar me “Udhezim i KM Nr 4 dt 17.05.2001, Udhezimi i KM, Nr 7 dat 21.11.2001, Udhezim i KM Nr 1 dt 22.02.2005 dhe Udhezim Nr 1. date 16.06.2011”
- Kontratës që do të lidhet me shoqërine fituese, për “Rikualifikimi i hapësirave midis Kuartallit nga rruga “Skenderbej” deri ne rrugen “Mars 91” e hapësira deri tek rruga e Portit, si dhe sistemimi i ujrave te Bardha tek ura e Dajlanit (Faza e I)+loti II”
- Kontrata do të qeveriset dhe interpretohet sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

Lidhet kontrata midis Bashkisë Durrës përfaqësuar nga Kryetari i saj **Z. Vangjush DAKO**, i mëposhtë quajtur “**Autoritetit Kontraktor**”

Dhe:

Subjektit, “**NORD - COMAT**” me Licencë MK. 2656/3 “Për Mbykqyrje dhe Kualidim të Punimeve të Zbatimit”, i regjistruar me numër unik identifikimi (NUIS): L08501501Q, me adresë: Dajt, LINZE, Lagjia Qesarake, Pallati i firmes Dodaj, Kati 1; Tel: 0682020102, përfaqësuar nga administratori z. Agostin **DODAJ**, më poshtë i quajtur: “**Mbikqyrësi i Punimeve**”.

Objekti i kësaj kontrate është drejtimi i punimeve të zbatimit me objekt: “Mbikqyrje punimesh per objektin: Rikualifikimi i hapësirave midis Kuartallit nga rruga “Skenderbej” deri ne rrugen “Mars 91” e hapësira deri tek rruga e Portit, si dhe sistemimi i ujrave te Bardha tek ura e Dajlanit (Faza e I)+loti II” në Durrës.

Palët bien dakort për kushtet që vijojnë:

1. Mbikqyrësi i punimeve përgjigjet për ndjekjen e realizimit pikë për pikë të kontratës së nënshkruar midis “Autoritetit Kontraktor ” dhe “Kontraktuesit” për realizimin e fazave të ndryshme të zbatimit të respektimit të afatit të dorëzimit dhe koston së objektit.
2. Mbikqyrësi i punimeve përgjigjet për ndërtimin e objektit në përputhje me projektin dhe kushtet teknike të zbatimit në fuqi për mbikqyrjen dhe përshkrimin e zbatimit të

projektit, cilësinë e materialeve të përdorura që të plotësojnë kërkesat e objektit si dhe për vendosjen në vepër të elementeve të parapërgatitura.

3. Mbikqyrësi i Punimeve i njofton me shkrim për çdo problem që mund të lind gjatë zbatimit të punimeve në objekt, Drejtorinë e Sherbimeve pranë Bashkisë Durrës.
4. Mbikqyrësi i punimeve duhet të ruaj dhe kontrollojë të gjitha dokumentat e përcaktuara me siper në bazen ligjore.
5. Mbikqyrësi i Punimeve gjatë zbatimit të objekteve ngarkohet të japë instruksione dhe urdhëra me shkrim "Autoritetit Kontraktor " sa herë që e sheh të nevojshme, "Kontraktuesit" është i detyruar t'i zbatojë ato. Ky i fundit ka të drejtë të bëjë me shkrim vërejtjet e tij lidhur me instruksionet dhe urdhërat e lëshuara nga ana e Mbikqyrësit të Punimeve.
6. Mbikqyrësi i Punimeve ka të drejtën që me miratimin e "Autoritetit Kontraktor" të japë urdhërat me shkrim për ndryshimet që ai i sheh të arsyeshme që duhen bërë gjatë zbatimit të veprës.
7. Materialet që do të përdoren në vepër duhet të jenë në përputhje me kërkesat e kontratave. Ato mund të përdoren në vepër vetëm me miratimin e Mbikqyrësit të punimeve. Materialet e ardhura në kantier që nuk pranohen nga Mbikqyrësi i punimeve zëvendësohen me të tjera me shpenzimet e "Kontraktuesit".
8. Mbikqyrësi i punimeve ka të drejtë të vendosi të bëjë prova të materialeve për të verifikuar cilësinë e tyre. Shpenzimet për këto prova janë në ngarkim të Kontraktuesit.
9. Kur Mbikqyrësi i punimeve mendon se ka defekte në konstruksione apo në pjesë të tjera të veprës, kërkon të bëhen verifikimet përkatëse. Kur verifikimet i japin të drejtë Mbikqyrësi të punimeve shpenzimet janë në ngarkim të "Kontraktuesit" në rast të kundërt "Kontraktuesit" ka të drejtë të kërkojë shlyerjen e shpenzimeve.
10. Sipërmarrësi duhet ti njoftojë me shkrim "Autoritetit Kontraktor "përfundimin e punimeve në objekt. Me këtë rast ai i paraqet Mbikqyrësit të punimeve dokumentacionin e nevojshëm.
11. Mbikqyrësi i punimeve duhet ti paraqesë "Autoritetit Kontraktor " dokumentacionin e nevojshme të marra në dorëzim nga "Kontraktuesit" së bashku me relacionin e vet.
12. Në përfundimin e punimeve që kanë afat kohor **150 ditë** sipas kontratës për objektin: "Mbikqyrje punimesh për objektin: Rikualifikimi i hapësirave midis Kuartallit nga rruga "Skenderbej" deri në rrugën "Mars 91" e hapësira deri tek rruga e Portit, si dhe sistemimi i ujrave të Bardha tek ura e Dajlanit (Faza e I)+loti II" Mbikqyrësi i punimeve duhet të depozitojë në Drejtorinë e Sherbimeve një relacion në dy kopje, rreth zbatimit të punimeve me karakteristikat dhe cilësinë e materialeve të përdorura në vepër duke paraqitur:

- a) Çertifikatat e provave të materialeve të përdorura lëshuar nga laboratorët e autorizuar për këtë qëllim.
- b) Për objektin çdo të dhënë për plotësimin në vepër të kësaj strukture.
- c) Përfundimet e provave të kryera nën ngarkesë duke bashkalidhur aktet e mbajtura për këtë qëllim.
- d) Deklarata që objekti është zbatuar në përputhje me projekt zbatimin, sipas formularit që merret nga “Autoritetit Kontraktor ” Njëra prej dy kopjeve të konfirmuara nga Mbikqyrësi i Punimeve i dërgohet kolaudatorit.
13. Mbikqyrësi i Punimeve asiston në kolaudimin e veprës i përgjigjet kolaudatorit për të gjithë dokumentacionin e nevojshëm gjatë kolaudimit të veprës si dhe firmos proces-verbalin e kolaudimit.
14. Mbikqyrësi i Punimeve është përgjegjës për fondin e veprës. Situacionet e paraqitura nga “Kontraktuesit” pas kryerjes së punimeve në faza të ndryshme mund të paguhen nga “Autoritetit Kontraktor ” vetëm pasi të jenë shqyrtuar dhe firmosur nga Mbikqyrësi i punimeve.
15. Mbikqyrësi i punimeve nuk duhet të ketë lidhje pune, gjaku apo interesash as me “Kontraktuesit” dhe as me kolaudatorin në të njëjtën kohë ai nuk duhet të ketë asnjë pengesë të këtij lloji me projektuesin. Për këtë qëllim Mbikqyrësi i punimeve do të bëjë një deklaratë me shkrim “Autoritetit Kontraktor ”.
16. Kur vërehen shkelje të dispozitave ligjore “Autoriteti Kontraktor ” ka të drejtë t’i urdhërojë Mbikqyrësit të Punimeve pezullimin e punimeve dhe i lind e drejta të kryej prishjen e kontratës duke kërkuar dëmshpërblim Mbikqyrësit të punimeve për dëmin e shkaktuar prej tij.
17. Kur vërehen shkeljet e dispozitave ligjore nuk përbëjnë vepër penale “Autoriteti Kontraktor ” mund të dënojë me gjobë Mbikqyrësin e Punimeve në përputhje të ligjit “Për kontrollin dhe disiplinimin e ndërtimeve”. Në rast se Mbikqyrësi i punimeve kryen shkelje financiare të cilat përbëjnë vepër penale përgjigjet në përputhje të legjislationit në fuqi.
18. Vlera e plotë e mbikqyrjes së objektit është: 2’419’450 (dy milion e katërqind e nentëmbëdhjetë mijë e katërqind e pesëdhjetë) lekë pa Tvsh dhe me vleftë me Tvsh: 2’903’340 (dy milion e nentëqind e tre mijë e treqind e dyzet) lekë, e ndarë në:
1. Mbikqyrje Rikualifikimi i hapësirave midis Kuartallit nga rruga “Skenderbej” deri në rrugën “Mars 91” e hapësira deri tek rruga e Portit, si dhe sistemimi i ujrave të Bardha tek ura e Dajlanit **Faza e I**, vlera është: 1’209’725 (një milion e dyqind e nente mijë e shtateqind e njëzet e pese) lekë pa Tvsh dhe me vleftë me Tvsh: 1’451’670 (një milion e katërqind e pesëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e shtatedhjet) lekë
 2. Mbikqyrje Rikualifikimi i hapësirave midis Kuartallit nga rruga “Skenderbej” deri në rrugën “Mars 91” e hapësira deri tek rruga e Portit, **loti II**, vlera është: 1’209’725 (një milion e dyqind e nente mijë e shtateqind e njëzet e pese) lekë pa

Tvsh dhe me vleftë me Tvsh: 1'451'670 (nje milion e katerqind e pesedhjet e nje mije e gjashteqind e shtatedhjet) lekë

19. Afati i kësaj kontrate shtrihet paralelisht me afatin e kontratës së lidhur ndërmjet "Autoritetit Kontraktor " dhe "Kontraktuesit" për zbatimin e objektit duke përfshirë dhe shtyerjet e mundëshme të afatit që mund të lindin gjatë zbatimit të kontratës.
20. Pagesa e Mbikqyresit te punimeve do te kryhet ne baze te përqindjes se situacioneve qe do te paraqiten per likuidim nga ana e shoqerise zbatuese te objektit.
21. Mbikqyrësi i punimeve gjatë gjithë veprimtarisë duhet të zbatojë të gjitha dispozitat e parashikuara në këtë kontratë si dhe kërkesat e detyrimet që rrjedhin nga ligji Nr.8402 date 10.09.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit", Udhezimit te KM Nr 3 date 15.02.2001 për "Mbikqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve te Ndertimit" i azhornuar me "Udhezim i KM Nr 4 dt 17.05.2001, Udhezimi i KM, Nr 7 dat 21.11.2001, Udhezim i KM Nr 1 dt 22.02.2005 dhe Udhezim Nr 1. date 16.06.2011 "Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", si dhe mban përgjegjësi sipas dispozitave ligjore në fuqi për mos respektimin e tyre.
22. Mosmarrëveshjet që lindin midis palëve zgjidhen me mirëkuptim në rast të kundërt, kompetente për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Rrethit Durres.
23. Kjo kontratë hartohet në 6 kopje prej të cilave një kopje e mban Mbikqyrësi i Punimeve dhe pesë kopje Investitori.

Autoriteti Kontraktor

BASHKIA DURRËS

Emri dhe firma e Përfaqësuesit

Vangjush Dako

Kryetar i Bashkisë

Vula:



Kontraktuesi

NORD - COMAT

Emri dhe firma e Përfaqësuesit

Agostin Dodaj

Administrator

Vula:

